

STATUT DHE AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “PREMIUM CLASS” SHPK

Sot në Tiranë, më datë 17.09.2023, në mbështetje të ligjit nr . 9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “ Për Qendren Kombëtare të Rregjistrimit” që rregullojnë marrëdhëniet tregtare dhe funksionimin e shoqërive, personat e mëposhtëm:

Z.**Elvis Cenollari**, shtetas shqiptar, atesia Asqeri dhe mëmësia Rruzhdie , i datelindjes 10/03/1988, lindur ne Terpan, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit nr. 038337514 dhe nr, identifikimi I80310096C dhe vlefshmeri deri me 14.06.2023.

Z.**Bledijan Hajdini**, shtetas shqiptar, atesia Fatmir dhe mëmësia Vera , i datelindjes 09/01/1993, lindur ne Zall-Bastar, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit nr. 038176404 dhe nr, identifikimi J30109105O dhe vlefshmeri deri me 23/03/2032.

*i cili me cilesine e ortakut themelues redaktoi aktin e themelimit, nepermjet te cilit ai deklaroi se me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare“, ne ligjin “Per QKB“, ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, “**TENDA DIELLI CLASS**” SHPK.*

KREU I

Neni 1 **Emertimi**

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “ **TENDA DIELLI CLASS** ” SHPK.

Neni 2 **Forma Juridike**

Shoqeria “ **TENDA DIELLI CLASS** ” SHPK, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”), e themeluar nga personat fizikë te siperpermendur, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe nuk mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë vetem deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria, pasi të ketë fituar

personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka seline ne: **rr. “Teodor Keko”, Godina nr.360, kati i pare, njesia bashkiake nr.6, Tirane .**

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyrë përfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Objekti i aktivitetit

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është: Shpërndarja dhe Montimi i të gjithë llojeve të Tendave të Diellit.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është përcaktuar në shumën **500,000 leke** (pese qind mijë leke) dhe është i përbërë nga 2 kuota. Vlera e një kuote është **5,000 leke**.

Z. Elvis Cenollari, është zotëues i 50 % të kuotave të kapitalit, me vlerë të përgjithshme 250,000 leke, që përbejnë 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë

dhe

Z. Bledijan Hajdini është zotëues i 50 % të kuotave të kapitalit, me vlerë të përgjithshme 250,000 leke, që përbejnë 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

KREU III
ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 7
Administrimi i shoqërisë

Shoqëria administrohet nga një administrator që zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë 5 vjeçare. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori zotëron kompetencat e plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë, përveç atyre që ligji ky Akt Themelimi dhe Statuti ja rezervon Asamblesë së përgjithshme apo organeve të tjera të shoqërisë,

Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve, akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e shoqërisë. Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të shoqërisë. Në rast konflikti të interesit, administratori do të njoftojë menjëherë ortaket si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

ADMINISTRATORET

- 7.1.** Administratorët të shoqërisë **“TENDA DIELLI CLASS” SH.P.K.** do të jenë bashkërisht **Z. Elvis Cenollari** dhe **Z. Bledijan Hajdini**, të cilët kanë secili të drejtë të përfaqësojnë shoqërinë në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri dhe me tagra dhe kompetencat e plota.
- 7.2.** Afati i këtij mandati fillon me regjistrimin e këtij Statuti në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe vazhdon **5 vjet** me të drejtë rizgjedhjeje, **pra nga data 17/09/2023 deri në datën 17/09/2028.**

NENI 8

Bilanci vjetor dhe dividendi

Viti Financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik.

Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabel të Autorizuar (nese janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori I paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si dhe llogaritë vjetore. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati të caktuar prej 3 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

Pasi të jete permbushur kerkesat e percaktuara nga Ligji “Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, Shoqeria me vendim te Asamblese se Pergjithshme vendos shperndarjen e dividendit ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.

NENI 9

Vliti financiar, llogarite vjetore, ndarja e fitimeve, dividendet

LLOGARITE FINANCIARE

- 9.1.** Në fund të çdo viti kalendarik duhet të hartohet një bilanc si dhe një llogaritje të fitimeve dhe humbjeve..
- 9.2.** Forma e bilanceve dhe librave të llogarisë që do të mbajë shoqëria, përcaktohen nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 10

DIVIDENTET

- 10.1.** Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Asambleja e Përgjithshme përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividendëve. Fitimi, që do të ndahet midis ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar, përbehet nga fitimi i vitit financiar dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

KREU V

KUFIZIMI I AFATIT, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

NENI 11

NDRYSHIME TE AFATIT

- 11.1.** Kufizimi apo zgjatja e afatit të aktivitetit të shoqërisë mund të vendoset nga Asambleja e Ortakëve me shumicën e ortakëve që zotërojnë mbi 1/2 e kapitalit themeltar.

NENI 12

PRISHJA E SHOQERISE

- 12.1.** Shoqëria priset në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë statut, me vendim të Asamblesë së Ortakëve me kërkesën e 1/2 të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar.

12.2. Shkaqet e prishjes së Shoqërisë;

- a. kur mbaron kohëzgjatje e parashikuar në themelimin e saj
- b. me vendim të Asamblesë së Përgjithshme
- c. me hapjen e procedurave të falimentimit.
- d. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në Q.K.B
- e. me Vendim Gjykate

Shoqëria nuk priset kur njëri nga ortakët falimenton, bëhet i paaftë ose vdes.

NENI 13

LIKUIDIMI I SHOQERISE

- 13.1.** Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Asambleja emëron një ose disa likuidues të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe të pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e domosdoshëm të përfundimit të tyre.
- 13.2.** Në fund të procesit të likuidimit Asambleja vendos, me shumicën e ortakëve që zotërojnë mbi 3/4 e kapitalit themeltar, mbi bilancin përfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmërisë të punës së likuiduesit dhe mbylljen e procesit të likuidimit.
- 13.3.** Pas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuesit përkatës, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin themeltar dhe njofton Q.K.B për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e Shoqërisë.

KREU VI

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 14

SHNDERRIMI I SHOQERISE

- 14.1.** Shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime mund të kryhet me miratim unanim të ortakëve, ndërsa shndërrimi në shoqëri aksionarë, me miratimin e shumicës së ortakëve që zotërojnë mbi 1/2 e kapitalit themeltar.
- 14.2.** Marrëdhëniet e brendshme ndërmjet punëtorëve dhe shoqërisë midis tyre dhe organeve të shoqërisë do të rregullohen me anën e një rregulloreje.

NENI 25

INTERPRETIMET STATUTORE

- 15.1.** Pavlefshmëria e dispozitave të veçanta të kësaj marrëveshje nuk e prek tërësinë e saj vepruese. Në vend të dispozitave të pavlefshme ose për mbushjen e hapësirave statusorë, ortaket bien dakord për një rregullim të përshtatshëm, në përputhje me qëllimin e hartimit të këtij statuti, duke ruajtur interesat e përbashkëta.
- 15.2.** Për gjithshka jo të parashikuar në këtë statut do të respektohen normat ligjore të legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 15.3.** Gjykate kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë, ose gjatë periudhës së likuidimit ndërmjet ortakeve, ndërmjet shoqërisë dhe ortakeve, apo ndërmjet shoqërisë dhe të tretave, do të jetë **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**.
- 15.4** Ky Statut hartohet në 3 ekzemplare origjinale, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ortaket e Shoqërisë **“TENDA DIELLI CLASS” SH.P.K.**

NENI 26

DISPOZITAT E FUNDIT

- 26.1** Për te gjitha çështjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- 26.2** Për efekt të interpretimit të këtij Statuti me ligj tregtar nënkuptohet ligji nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”
- 27.3** Pavlefshmëritë eventuale e dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të cenojnë vlefshmërinë në tërësi të tij.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE “TENDA DIELLI CLASS” SH.P.K.

ORTAK 1

Z. ELVIS CENOLLARI

ELVIS CENOLLARI


ORTAK 2

Z. BLEDIJAN HAJDINI

Bledijan Hajdini
